



Republika e Kosovës



Komuna Vushtrri

Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim

R A P O R T

Pune për vitin 2011

Janar, 2012

SEKTORI PËR ZHVILLIM EKONOMIK-BIZNES:

Ky sektor i Drejtoris për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim, fillimin e vitit 2011 e ka startuar me një plan të punës i cili si synim kryesor e ka paraparë që shumica e bizneseve të cilat ushtrojnë veprimtarinë në territorin e komunës sonë të pajisen me leje komunale për ushtrimin e veprimtarisë së tyre.

- Objektivi që kishim për themelimin e Qendrës Komunale të Biznesit është realizuar dhe qendra filloi të jetë aktive gjatë muajit maj të këtij viti.

Para fillimit të punës së QKB – së është përgaditur stafi profesional për kryerjen e punëve në mënyrë sa më efikase dhe profesionale, duke ndjekur trajnimet gjegjëse dhe vizitat nëpër raste të suksesshme.

Deri me 31.12.2012 në Sektorin për Biznes të Drejtoris për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim janë pranuar dhe procesuar 732 lëndë, prej tyre:

- leje pune janë	143
- vazhdim i lejeve të punës	545
- certifikata	29
- informata	<u>15</u>
Gjithsej:	732

Është për t'u theksuar se gjatë këtij viti kemi pasur ngritje të numrit të bizneseve të cilat kanë aplikuar dhe pajisur me leje komunale të punës.

Ndërsa sa i përket regjistrimit të bizneseve, nga Agjencion për Regjistrimin e Bizneseve të Kosoves, është bërë delegimi i kompetencave për themelimin e QKB.

QKB – ja ka filluar me punë që nga data 24-05-2011 dhe që në fillim vërehet një fluks i madh i qytetarëve për regjistrimin e bizneseve të reja, si dhe ndryshime tjera në bizneset ekzistuese.

Vetëm deri më datën 31.12. 2011, kemi pranuar 278 aplikacione për regjistrim, dhe atë:

- regjistrimet e reja	119
- ndryshimet në bizneset ekzistuese	74
- regjistrim i ri i SHA	52
- ndërrim i logos	33

Gjithsej: 278

Fillimi i punës së QKB – së ka ndikuar shumë pozitivisht tek pronarët e bizneseve të cilët nuk shpenzojnë më për regjistrim apo ndryshime në

biznes për të cilat deri më tani kanë shkuar në Prishtinë, por që nga data 24.05.2011 këtë e bëjnë në QKB pa shpenzime dhe pa humbur shumë kohë.

Themelimi i QKB ka ndikuar pozitivisht edhe në komunë sepse tani e tutje komuna do të ketë qasje direkte në bizneset e regjistruara dhe të gjitha ndryshimet që bëhen në bizneset e Komunës së Vushtrrisë por edhe në harmonizim më të ngushtë në mes të Drejtorive për Inspektion dhe Buxhet e Financa.

Sipas të dhënave nga QKB- del se në Komunën e Vushtrrisë deri më datën 31.12.-2011 janë të regjistruara gjithsej 119 biznese nga 24.05.2011

CODE	VEPRIMTARIT EKONOMIK	Bizneset prej 24.05.2011deri më 30-12-2011	%
1	2	3	4
A	Bujqësia, Gjuetia dhe Pylltaria		
B	Peshkimi		
C	Industria e Minierave dhe Ekstraktuese		
D	Industria përpunuese	12	10.08
E	Furnizimi me energji elektor. dhe ujë		
F	Ndërtimtaria	5	4.20
G	Treg.me shumicë dhe pakicë rip.i auto.dhe aparateve tjera të amvisërisë	47	39.50
H	Hotelet dhe Restorantet	11	9.25
I	Transporti,depotë dhe telekomunikacioni	30	25.21
J	Aktivitetet Financiare	1	0.84
K	Pasuritë e patundshme:dhënia me qira dhe aktivitetet e biznesit	3	2.52
M	Administrimi dhe Mbrojtja publike Mbrojtja e obligueshme sociale	1	0.84
N	Arsimi	3	2.52
O	Aktivitet tjera shoqërore dhe personale	6	5.04
	Totali	119	100

-Nga të dhënat në tabelën e mësipërme del se si veprimtari kryesore që ende dominon është tregëtia me 47 biznese apo 39.50 %, pastaj veprimtaria e transportit me 30 biznese apo 25.21%, mandej veprimtaria e transportit, industrisë etj.

- Gjatë kësaj periudhe kemi zhvilluar edhe aktivitete për të grumbulluar të hyra për buxhetin komunal si p.sh ato për shfrytëzimin e hapësirës publike në treg në shumë 14.187, 95 euro.

-Nga data 03-10-2011 ka filluar punën tregu i ri i qytetit;

- Që nga data 09-08-2011 në bazë të vendimit të ARBK-ës të gjitha bizneset që aplikojnë për regjistrim fillestar do të lirohen nga pagesat për regjistrim të biznesit, vlerësohet që si rrjedhojë e këtij vendimi ka rritje të numrit të bizneseve të regjistruara;

- Kemi formuar një komision komunal i cili është në përfundim e sipër të numrimit të të gjitha bizneseve që afarojnë në komunën tone.

Kemi punuar që të ngrisim në nivel më të lartë bashkëpunimin duke koordinuar punët-aktivitetet në mes të Drejtorive për Ekonomi, Bujqësi e Zhvillim, të Inspekcionit dhe asaj për Buxhet dhe Financa.

-Hapat e ardhshëm:

1/ Jemi në përpjekje dhe do të vazhdojmë edhe më tutje iniciativën për formimin e Shoqatës së Afaristëve të Vushtrrisë.

2/ Në çdo javë do të organizojmë dy orë vizita të drejtëpërdrejta me bizneset e vendit me qëllim informimin e gjendjes së tyre në mënyrë të prekshme;

3/ Angazhimet e stafit tonë do të jenë që në fillim të vitit 2012, të realizojmë dhe publikojmë një palosje për zhvillimet në sektorin e biznesit me të dhëna dhe statistika kryesore nga kjo lëmi.

SEKTORI PËR BUJQËSI :

Në vitin 2011 në Sektorin e Bujqësisë, konsiderojmë që ka qenë një dinamikë e madhe e punëve.

Më poshtë paraqesim listën që përmban planifikimin dhe realizimin e mbjelljeve pranverore:

Nr .	Kulturat	Sipërfaqja e planifikuar në ha	Sipërfaqja e realizuar në ha	Çmimet në treg
1.	Misër	3.600	3.510	23 € / 25000 kokrra
2.	Elb	160	152	0.35 € /kg
3.	Tërshërë	700	640	0.30 € /kg
4.	Bimë foragjere	330	350	3.5 – 3.7 € / kg
5.	Bimë industriale	20	20	
6.	Perime	300	310	
7.	Patate	1.360	1.400	0.70€ /kg
8.	Fasule monokulturë	20	15	2€ /kg
9.	Të tjera	10	10	
10				
Gjithsej:		6.500	6.407	

-Ne gjatë muajit mars kemi pranuar kompetenca shtesë në lidhje me punët e aplikimit nga fermerët në grante dhe në subvencione por edhe në hartim të projekteve bujqësore që shpërndan MBPZHR-al;

Nga ky aktivitet ofrojmë këtë listë që ju kemi asistuar fermerve gjatë aplikimit:

Nr.	Fermeri	Vendi	Lloji i investimit	Shuma
1.	Naim Bejta	Smrekonicë	Blegtori	10,000.00
2.	Nebih Tahiri	Druar	Pemëtari	4,000.00
3.	Mexhit Beqiri	Pantinë	Pemëtari	4,000.00
4.	Ukshin Shabani	Novolan	Pemëtari	4,000.00
5.	Hetem Jonuzi	Pasomë	Pemëtari	4,000.00
6.	Burim Selmani	Ashlan	Pemëtari	18,000.00
7.	Driton Morina	Akrashticë	Perime	40,000.00
8.	GLV-ja	Vushtrri	Infrastrukturë	7,000.00 +3,000.00

Kushti i përfitimit të grantit nga qeveria ka qenë pjesëmarrja në investim me 50%. Informatat e tjera në WEB-faqe të MBPZHR-al.

-Nga subvencionimi i fermerve që kishin dele dhe dhi kanë përfituar gjithsej 47 fermerë, ndërsa

-Nga subvencionimi i gjedheve kanë përfituar gjithsej 208 fermerë në komunën tonë;

-Janë subvencionuar gjithsej 39 autokombajnerë me gjithsej 55 autokombajna.

-Tabela e më poshtme pasqyron listën e të gjithë fermerëve që kanë përfituar në komunën tonë nga IADK(Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës):

Nr.	Lloji i investimit	Fermeri	Vendi	Shuma nga IADK	Participimi i fermerit
1.	Pajisje për fermë	Nazmi Osmani	Bukosh	52,000.00	5,200.00
2.	Pajisje për qumësht	Skënder Osmani	Mihaliq	8.100.00	2.415.00
3.	Pajisje për qumësht	Fadil Haziri	Kollë	8.100.00	2,415.00
4.	Serrë-komplet	Avni Hasani	Pantinë	4,500.00	842.00
5.	Serrë-komplet	Arben Bajrami	Mihaliq	4,500.00	842.00
6.	Pikë grumbulluese e frutave pyjore	Shefqet Bunjaku	Studime e Epërme	10,000.00	1.000.00
7.	Perime-Kornishon	Selim Kasumi	Pestovë	581.00	235.00
8.	Perime-Kornishon	Ragip Bunjaku	Vushtrri	581.00	235.00
9.	Perime-Kornishon	Kastriot Tahiri	Stanoc i Ulët	581.00	235.00
Gjithsej investime:				88.943	13.419

-Gjatë këtij viti është përfunduar edhe vaksinimi i qenve endacak dhe qenëve shtëpiak;

-Njëkohësisht kanë përfunduar katër aksione për eliminim e qenëve endacak;

Mbjelljet vjeshore për vitet 2011-2012 të paraqitura në mënyrë tabelare

	Kultura	Sipërfaqja/ha
1.	Grurë	3.870 ha
2.	Elb	240 ha
3.	B. Foragjere	92 ha

Gjatë kësaj periudhe kanë aplikuar në thirrjen për subvencionimin e grurit (prej 10 nëntorit deri më 31 dhjetor 2011)- 467 fermerë.

-Komuna ka participuar edhe në projektin e përfituar nga Komisioni Evropian me 10.000 €(gjithsej shuma e projektit të përfituar 447.000 euro – projekt regional), nga i cili projekt do të përfitojë një fermer nga komuna jonë 52.000 €, në ndërtim të një model-ferme në blegtoria(procedurat zhvillohen nga IADK dhe KE).

- Gjatë vitit 2010 kemi nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me HPI-Kosova(“Hejfer Kosova International), në zhvillim të një projekti në lëmin e blegtorisë, ndërsa gjatë muajit shtator 2011 pjesa e parë e këtij projekti është realizuar, ndërsa pjesa e dytë pritet në mars të vitit 2012.

Projekti ka vlerën totale 50.000 €, në të cilin Komuna e Vushtrrisë ka participuar me 15.000 €, ndërsa pjesën tjetër do e mbulojë HPI-Kosova. Ky projekt nënkupton mbështetjen e 20 familjeve me gjendje jo të mirë ekonomike me nga një gjedhe qumështore të racës Simental nga Evropa. Projekti është i planifikuar dhe po realizohet në fshtatrat Karaçë, Tërllobuq dhe Sumë.

- Jemi në realizim e sipër të projektit për rregullim të një pjese në bedenat e lumit “Silnica”.

-Hapat e ardhshëm:

1/Realizimi i investimit në disa pika me emergjente në rregullim të badenave;

2/ Shpalljen e tokave bujqësore dhe kullosave në shfrytëzim të përkohshëm me kompenzim;

3/ Realizimi i një palosje në fillim të vitit 2012 me statistika dhe aktivitete nga Sektori i Bujqësisë;

SEKTORI PËR PYLLTARI :

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2011 në Sektorin e Pylltarisë janë zhvilluar shpeshherë kontrolla të rrepta dhe të harmonizuara edhe me Stacionin Policor.

Pasqyra e më poshtme tregon aktivitetet e ndërmarra në këtë sektor:

Renditja	Përshkrimi	Vendi	Numri	Vërejtje
1	Kontrolla	Bukogllavë(Vesekoc),Qyqavicë – II,-III-,Qukë e Skoqnës, Sllakoc, Gërdeq	117	
2	Patrollime	Qytet, treg dhe në aksion rrugor(magjistrale-hyrjet kryesore në qytet)	67	
3	Aksione	Gjatë shitjes ilegale, në treg, në terrenet pyjore	35	34 konfiskime
4	Kontakt pune	Me komandantin e stacionit policor si dhe bashkëpunëtorët e tij për koordinim të punëve	17	
5.	Regjistrim i rregullt i terreneve	“Qyqavica- I,- II,-III-, Vesekoc –(Bukogllavë) Sllakoc Gërdeq Qukë e Skoqnës	1	Angazhimi i ish-teknikut të pyjeve në këtë vend është bërë me terren dhe gjendje të regjistruar të pyjeve.
6.	Vlersime të dëmeve	Në pyje private dhe shtetërore	12	
7.	Konfiskime të masës drunore pa dokumentacion përkatës	Gjatë shitjes në treg në formë ilegale, dhe gjatë terrenit pyjor	64.70 m ³	
8.	Fletëparaqitje për kundërvajtje	Të drejtuara në Gjykatën komunale	56 lënd-12,046.75 €	Fletëparaqitje për 96.05 m ³
9.	Fletëparaqitje penale të dëmit pyjor	Të drejtuara në Gjykatën komunale	15 lënd 8.904,51 €	60,33 m ³
10.	Furnizim me masë drunore	Familjeve skamnore, shkollave dhe zyrës së vendit në fsh.Maxhunaj	70.00 m ³	
11.	Të tjera: Pranim dhe shqyrtim të kërkesave	Këkresa të shqyrtuara për prerje ligjorë në pyjet private	61 copë	
12.	Prerje	Vulosje figure dru-zjarri	538.25 m ³	
13.	Dëmkosje të trungjeve	Dëmkosje në pyje private	550.44 m ³	
14.	Raport i të hyrave	Të hyrat nga shërbimet në pyje private dhe shoqërore	1791.78 €	
15.	Pyllëzim	Sipërfaqe të pyllëzuara	15.20 ha	38.011 fidane

Hapat e ardhshëm:

- 1/ Përpjekje në përmirësim të gjendjes së pylltarëve dhe sektorit në përgjithësi;
- 2/ Përpjekje më e shtuar e pylltarëve në mbrojtje të pyjeve;
- 3/ Pastrim dhe rrallim të pyjeve publike konform ligjit mbi pyjet;
- 4/ Publikimi i një palosje(fletushke) në shkurtë-2012, në lidhje me vetëdijësimin e mbrojtjes së pyjeve dhe publikimin e disa të dhënave;
- 5/ Paraqitja e një plani rreth disa ndryshimeve të gjendjes së këtij sektori;

Me respekt,

Drejtori për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim:
Nasuf ALIU